


Tregtia e jashtme e mallrave*

Shtator 2025

Tiranë, më 24 Tetor 2025: Në Shtator 2025 eksportet e mallrave arritën vlerën 27 mld lekë, duke u ulur me 10,7 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe duke u rritur me 34,6 %, në krahasim me Gusht 2025. Importet e mallrave arritën vlerën 75 mld lekë, duke u rritur me 5,6 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 11,8 %, në krahasim me Gusht 2025. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 48 mld lekë, duke u rritur me 17,8 %, krahasuar me Shtator 2024 dhe me 1,9 %, në krahasim me Gusht 2025.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në këtë nëntëmujor eksportet e mallrave arritën vlerën 260 mld lekë, duke u ulur me 7,9 %, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 657 mld lekë, duke u ulur me 1,3 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 397 mld lekë, duke u rritur me 3,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2024.

1
Në kuadër të përmirësimeve metodologjike nga burimi i informacionit, INSTAT ka kryer rishikime në statistikat e tregtisë së jashtme të mallrave. Këto përditësime janë pasqyruar në seritë mujore dhe vjetore, me qëllim sigurimin e saktësisë, përputhshmërisë dhe cilësisë së të dhënave sipas Rregullores së Revizionimit Statistikor ([STATISTICAL REVISION POLICY](#)). Rishikimet përfshijnë periudhën 2021–2025.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Gjatë muajit Shtator 2025, në uljen e eksporteve prej 10,7 %, negativisht kanë ndikuar grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -8,4 pikë përqindje dhe “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -2,4 pikë përqindje. Pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Tekstile dhe këpucë” me +1,4 pikë përqindje dhe “Ushqime, pije, duhan” me +0,2 pikë përqindje, etj.

Fig. 2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Shtator 2025




Eksportet, gjatë këtij nëntëmujori janë ulur me 7,9 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -6,6 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me -1,2 pikë përqindje, etj. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Ushqime, pije, duhan” me +1,0 pikë përqindje dhe “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +0,5 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Gjatë muajit Shtator 2025, në rritjen e importeve prej 5,6 %, krahasuar me një vit më parë, kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +2,0 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +1,5 pikë përqindje, etj. Ndërsa negativisht ka ndikuar grupi: “Lëkurë dhe artikujt prej tyre” me -0,1 pikë përqindje.

Fig. 3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Shtator 2025



Si nëntëmujor, importet janë ulur me 1,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të importeve, janë: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me -1,5 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -1,0 pikë përqindje, etj. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” dhe “Ushqime, pije, duhan” me +0,7 pikë përqindje dhe “Produkte kimike dhe plastike” me +0,2 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Shtator 2025, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të eksporteve, në krahasim me Shtator 2024 janë: Italia (0,7 %), Spanja (49,9 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur rritjen më të madhe, janë: Kosova (8,1 %), Greqia (32,5 %), Gjermania (2,3 %), etj.

Gjatë këtij nëntëmujori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (10,8 %), Kosova (13,5 %) dhe Kina (3,0 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur rritjen më të madhe, janë: Greqia (6,4 %) Gjermania (5,6 %) dhe Spanja (27,5 %).

Në muajin Shtator 2025, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritjen më të madhe të importeve, janë: Italia (9,9 %), Kina (39,8 %) dhe Greqia (10,9 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Turqia (7,3 %), Gjermania (1,5 %), etj.

Gjatë këtij nëntëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (2,8 %), Turqia (14,3 %) dhe Gjermania (6,4 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur rritje më të madhe janë: Kina (23,5 %), Greqia (4,0 %) dhe Spanja (14,1 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Shtator 2025



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 57,5 %, të gjithë tregtisë. Në Shtator 2025, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 74,6 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 51,3 % të importeve gjithsej.

Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (27,7 %), Kina (12,6 %), Greqia (8,3 %) dhe Turqia (6,7 %).

Shkëmbimet tregtare, për nëntëmujorin 2025, me vendet e BE-së zënë 57,4 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar-Shtator 2025, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 73,3 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 51,1 % të importeve gjithsej.

Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (26,9 %), Kina (10,3 %), Greqia (7,7 %) dhe Turqia (7,3 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Shtator 2025

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2020		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2021		367	35,0	801	32,3	-434	45,8
2022		481	30,9	950	21,2	-470	50,6
2023		430	-10,4	873	-8,2	-442	49,3
2024		369	-14,3	894	2,5	-526	41,2
2023	01 - 23	42	20,4	58	5,8	-16	71,9
	02 - 23	38	3,6	69	1,1	-32	54,4
	03 - 23	42	-9,7	81	-3,7	-39	51,8
	04 - 23	34	-19,6	75	-3,9	-41	45,1
	05 - 23	39	-11,9	81	1,2	-41	49,0
	06 - 23	37	-17,9	75	-7,5	-38	49,9
	07 - 23	35	-10,4	71	-13,6	-36	49,3
	08 - 23	24	-29,7	68	-15,0	-44	35,6
	09 - 23	33	-13,1	73	-16,6	-40	45,2
	10 - 23	36	-4,1	78	-6,3	-42	46,7
	11 - 23	33	-21,5	72	-7,4	-39	45,8
	12 - 23	37	-6,5	73	-23,1	-36	50,9
	Jan-Dhj. 23	430	-10,4	873	-8,2	-442	49,3
2024	01 - 24	29	-30,0	60	3,4	-31	48,7
	02 - 24	32	-16,0	74	6,4	-42	43,0
	03 - 24	33	-20,8	75	-7,0	-42	44,1
	04 - 24	34	2,2	75	0,6	-41	45,7
	05 - 24	35	-12,5	79	-1,6	-45	43,5
	06 - 24	34	-8,6	77	2,1	-42	44,7
	07 - 24	33	-6,1	85	21,1	-53	38,2
	08 - 24	22	-8,4	69	1,9	-47	32,0
	09 - 24	30	-8,2	71	-3,1	-41	42,9
	10 - 24	31	-15,4	77	-1,5	-46	40,1
	11 - 24	30	-8,3	73	2,0	-43	41,2
	12 - 24	25	-31,4	79	8,3	-53	32,2
	Jan-Dhj. 24	369	-14,3	894	2,5	-526	41,2
2025	01 - 25	28	-6,1	60	0,1	-32	46,4
	02 - 25	30	-6,4	68	-8,6	-37	44,6
	03 - 25	31	-5,7	74	-1,4	-42	42,5
	04 - 25	30	-13,6	76	0,4	-46	39,5
	05 - 25	32	-8,5	78	-2,1	-46	41,0
	06 - 25	31	-10,1	77	-0,2	-45	40,8
	07 - 25	30	-8,6	83	-2,4	-53	36,5
	08 - 25	20	-10,1	67	-2,7	-47	30,1
	09 - 25	27	-10,7	75	5,6	-48	36,3
	Jan-Sht. 25	260	-7,9	657	-1,3	-397	39,6

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë), Shtator 2025

	Eksporte				Importe			
	Shtator 2024	Shtator 2025	Jan. – Sht. 2024	Jan. – Sht. 2025	Shtator 2024	Shtator 2025	Jan. – Sht. 2024	Jan. – Sht. 2025
Vendet e BE-së	21.393	20.309	200.010	190.633	36.151	38.440	341.857	335.944
Austri	159	123	1.804	1.280	757	486	6.015	5.253
Gjermani	1.676	1.715	16.408	17.333	5.139	5.063	47.411	44.390
Greqi	1.628	2.157	16.557	17.609	5.711	6.333	50.954	53.001
Itali	12.518	12.432	123.505	110.152	14.425	15.852	140.319	136.343
Spanjë	1.813	908	9.717	12.389	886	1.017	9.941	11.342
Kroaci	160	169	2.178	1.981	494	529	3.788	5.450
Të tjera të BE-së	3.439	2.804	29.841	29.890	8.739	9.160	83.428	80.166
Mbretëri e Bashkuar	96	77	1.104	853	707	498	7.261	6.555
Kinë	1.045	1.212	8.396	8.140	8.333	11.648	69.908	86.349
Kosovë	2.185	2.363	29.041	25.107	1.460	2.074	12.154	11.515
Maqedonia e Veriut	546	515	9.743	6.736	928	1.408	8.937	10.702
Rusi	-	0	7	6	412	506	2.861	3.003
SHBA	2.868	219	5.837	2.910	1.845	1.173	14.800	13.402
Turqi	284	387	2.939	3.999	6.973	6.463	73.655	63.153
Ukrainë	219	0	2.720	373	213	265	3.143	2.663
Zvicër	165	139	1.854	1.039	1.199	537	6.653	6.570
Të tjera	1.660	1.986	20.889	20.389	12.797	11.969	124.416	117.047
Gjithsej	30.461	27.206	282.542	260.186	71.019	74.979	665.644	656.903

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë), Shtator 2025

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Shtator 2024	Shtator 2025	Jan. – Sht. 2024	Jan. – Sht. 2025	Shtator 2024	Shtator 2025	Jan. – Sht. 2024	Jan. – Sht. 2025
Gjithsej	30.461	27.206	282.542	260.186	71.019	74.979	665.644	656.903
Ushqime, pije, duhan	3.502	3.571	38.540	41.402	12.682	13.764	117.066	121.462
Minerale, lëndë djegëse, en.el.	4.762	4.019	52.279	48.968	8.336	9.779	69.096	73.712
Produkte kimike dhe plastike	1.295	977	11.764	9.687	9.523	9.616	86.119	87.324
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	140	178	1.510	1.411	921	870	8.797	8.243
Prodhime druri dhe letre	845	846	7.444	7.416	2.262	2.324	22.259	21.977
Tekstile dhe këpucë	8.810	9.250	78.970	78.735	7.847	8.018	64.015	63.029
Materiale ndërtimi dhe metale	6.680	4.110	53.906	35.182	8.842	9.129	92.307	85.625
Makineri, pajisje dhe pj. këmb.	3.598	3.472	28.151	29.525	17.726	18.201	176.189	166.430
Të tjera	828	784	9.978	7.860	2.880	3.279	29.798	29.102

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Janar - Shtator 2025

	Itali		Kosova		Greqi		Gjermani	
	2024	2025	2024	2025	2024	2025	2024	2025
Gjithsej	123.505	110.152	29.041	25.107	16.557	17.609	16.408	17.333
Ushqim, pije duhan	10.258	8.786	4.708	5.355	3.201	3.610	1.365	1.396
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	10.157	3.293	6.405	11.425	1.503	882	4.665	3.762
Produkte kimike dhe plastike	4.323	3.317	3.157	2.207	728	639	41	45
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.296	1.163	5	14	146	138	1	0
Prodhime druri dhe letre	3.936	3.902	944	857	1.168	1.132	94	97
Tekstile dhe këpucë	59.326	56.879	129	102	5.842	7.097	6.892	7.927
Materiale ndërtimi dhe metale	16.076	14.995	11.135	2.337	3.191	3.184	803	677
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	14.229	13.900	1.559	1.996	183	182	2.234	3.071
Të tjera	3.905	3.917	1.000	815	593	744	312	359

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Janar - Shtator 2025

	Itali		Kinë		Turqi		Greqi	
	2024	2025	2024	2025	2024	2025	2024	2025
Gjithsej	140.319	136.343	69.908	86.349	73.655	63.153	50.954	53.001
Ushqim, pije duhan	23.829	26.104	1.293	1.606	4.077	3.894	14.357	15.810
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	3.630	5.361	17	13	8.567	6.276	8.329	7.742
Produkte kimike dhe plastike	17.199	16.996	5.667	6.643	9.185	8.626	8.345	9.202
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	6.725	6.251	759	731	260	308	123	106
Prodhime druri dhe letre	4.523	4.634	1.507	1.853	3.576	3.474	3.034	3.168
Tekstile dhe këpucë	26.764	25.608	10.522	11.148	8.720	7.272	4.748	5.336
Materiale ndërtimi dhe metale	16.391	15.290	9.511	14.882	21.863	20.851	6.802	6.060
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	32.756	28.936	34.460	42.288	14.211	9.051	3.395	3.911
Të tjera	8.500	7.163	6.171	7.185	3.196	3.401	1.823	1.666

Metodologjia

Publikimi i statistikave të Tregtisë së Jashtme, është subjekt i rishikimeve metodologjike, të cilat mbështeten në të dhënat administrative nga autoritetet doganore.

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës. Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Definicionet:

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë. të vendosura nën regjimin doganor. në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues. pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë. të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë. për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues. pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri